

## **Valbona Sanxhaktari**

### Komisionere

Diplomuar “Jurist” në vitin 1996 në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2007, ajo është pajisur me licencën e avokatisë. Znj.Valbona Sanxhaktari, që nga viti 2014 mban gradën shkencore “Doktor”. Karriera e saj profesionale ka nisur në vitin 1996, fillimisht si asistentavokate. Nga gushti i vitit 1998 deri në tetor 2001, znj. Valbona Sanxhaktari ka mbajtur detyrën e inspektore pranë Drejtorisë së Inspektoratit të Lartë Shtetëror të Punës. Më tej, ajo ka punuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në pozicionin e juristes. Pas këtyre eksperiencave, znj.Valbona Sanxhaktari u emërua në postin e drejtores në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Dr. Sanxhaktari ka shërbyer si eksperte ligjore dhe konsulente jo vetem në institucione publike, por edhe në organizata të huaja, si UNDP dhe Banka Botërore. Mësimdhënia është një tjetër fushë ku ajo ka dhënë kontributin e saj si pedagoge që prej vitit 2006. Nga viti 2014 deri në vitin 2017 ka punuar si juriste në Njësinë e Legjislacionit dhe Akteve të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri. Në qershor të vitit 2017, Dr. Valbona Sanxhaktari u zgjodh nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.